



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga: "Abdi Toptani" nr.1, Tiranë

E-mail: klsh.org.al; Web-site www.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 14.12.2018

V E N D I M

Nr.190, Datë 14.12.2018

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË E TRAJTIMIT TË PRONAVE, TIRANË "MBI DHËNIEN E NJË VLERËSIMI OBJEKTIV, PROFESIONAL E TË PAVARUR, MBI SHKALLËN E NDJEKJES NGA SUBJEKTI I RREGULLAVE, LIGJEVE DHE RREGULLOREVE, POLITIKAVE, KODEVE DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE NË AGJENCINË E TRAJTIMIT TË PRONAVE, VLERËSIMIN E PËRPUTHSHMËRISË ME LIGJET DHE RREGULLORET" për periudhën nga data 01.07.2016 deri në 30.04.2018.

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave Tiranë, rezultoi se veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për trajtimin e pronave, nuk ka qenë plotësisht efektive si rrjedhojë e mangësive procedurale në zbatimin e ligjshmërisë dhe në hartimin e dokumentacionit tekniko ligjor. ATP nuk ka vlerësuar financiarisht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka patur prona në kohën e shpronësimit, duke shmangur procedurën e plotë ligjore për identifikimin e llojit të pasurisë në kohën e shpronësimit (mund të ketë qenë tokë bujqësore, pyll, kullotë etj.) Vendimet për kompensim janë marrë në mungesë të dokumentit të shpronësimit për sipërfaqet e kompensuara, mbi bazën e të cilit do të përcaktohej koha e shpronësimit, si dhe zëri kadastral i pronës në kohën e shpronësimit. Janë konstatuar shkelje e mangësi në zbatimin e kontratave të shërbimit për implementimin e sistemit Web-Gis, dhe shkelje të disiplinës financiare, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, nisur nga fakti se nga auditimi janë konstatuar shkelje dhe parregullsi ligjore, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për pronat e trajtuara" të ushtruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, Tiranë, sipas programit të auditimit nr.542/1 prot., datë 07.05.2018, për veprimtarinë e kryer gjatë periudhës nga data 01.07.2016 deri më 30.04.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A.MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje: Në Agjencinë e Trajtimit të Pronave (këtu e poshtë ATP), në zbatimin e rekomandimeve të dërguara dhe riaudituar nga ana e KLSH-it me program auditimi për zbatimin të rekomandimeve, është konstatuar se 2 rekomandime të lëna në auditimin e mëparshëm për arkëtimin e vlerës **125,854,404 lekë**, nuk janë zbatuar dhe pranuar për shkak të ndryshimeve ligjore dhe nuk ka patur fushë zbatimi. Për këtë ATP nuk ka ndjekur procedurat ligjore të bashkëpunimit, argumentimit ligjor apo pasqyrimin të mungesës së fushës së zbatimit, për arsyet e cituara, veprime në kundërshtim me nenin 15 (pika k), nenin 29 “pika 2” dhe nenin 30 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” (*Më hollësisht trajtuar nënë pikën 1, faqet 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: ATP të marrë masa, duke hartuar një program masash për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna, si dhe nëse ka argumente ligjore, të paraqesë arsyet e moszbatimit nga mungesa e fushës së zbatimit apo vakumi ligjor, etj., duke njoftuar KLSH.

Brenda muajit Shkurt 2019

2.Gjetje: Në ATP janë konstatuar pasaktësi të hedhjes së të dhënave në pasqyrat e paraqitura elektronikisht, kolonat janë të paplotësuara me të gjitha modalitetet e duhura, nuk janë dokumentuar dhe nuk janë rakorduar 26 dosjet dhe një regjistër i të dhënave të cilat janë djegur. Nuk janë rakorduar dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore në kundërshtim me të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, nenin 40 “Dhënia dhe marrja në dorëzim e dokumenteve (Mod. 15)”, ku citohet: “*Institucionet fondkrijuese të dokumenteve të numerizuara dorëzojnë pranë arkivave përkatës, në të njëjtët bartës që kanë regjistruar dokumentet, edhe mjetet e informimit dhe të kërkimit arkivor*” (ku ATP është institucion fondkrijues), si dhe Rregulloren e brendshme nr.277, date 10.10.2016 për “*Organizimin, funksionimin, detyrat dhe kopetencat e administratës në Agjencinë e Trajtimit të Pronave*” në mbështetje të këtij ligji (*Më hollësisht trajtuar në faqet 24-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: ATP të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore në përshtatshmëri me ligjet për të gjitha dosjet e marra në dorëzim dhe të arkivuara dhe të nxjerrë përgjegjësinë ligjore për dosjet e djegura.

Brenda muajit Shkurt 2019

3.Gjetje: Janë rreth **656 dosje** në ATP, të cilat kanë kaluar nga arkiva në protokoll dhe me urdhër u janë shpërndarë specialistëve përkatës. Për këto dosje nuk kanë përfunduar procedurat ligjore për të marrë një vendim, por procesi është zgjatur e zvarritur me 3-4 vite. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar me datë 20.12.2017, pikës 6 të VKM nr.222, datë 23.3.2016 “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj” të ndryshuar, si dhe me Rregulloren e brendshme nr.277, datë 10.10.2016 neni 6, 8,16 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 26-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: ATP të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për një vendimmarrje të detajuar në afatet kohore të përcaktuara në ligj për të gjitha dosjet e shpërndara specialistëve dhe të raportojë mbi vijueshmërinë e tyre deri në vendimet përkatëse, duke nxjerrë përgjegjësinë për situatën e krijuar.

Brenda muajit Shkurt 2019

4.Gjetje: Në ATP janë **145 dosje** për të cilat janë dërguar shkresat për “Plotësim dokumentacioni” subjekteve përkatëse, dhe të cilave u kanë kaluar afatet ligjore të paraqitjes së dokumentacionit plotësues tekniko-ligjor nga subjektet. Nuk janë respektuar afatet për këto dosje nga specialistët, si dhe nuk janë përfunduar procedurat ligjore për paraqitjen e informacionit përgatës argumentues deri në vendimmarrje, në mënyrë që procesi i trajtimit të pronave për këto subjekte të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Në dosjet e trajtuara në vitin 2014, ATP ka nisur shkresat për plotësim dokumentacioni dhe personi i autorizuar nuk ka paraqitur dokumentat ligjorë sipas shkresës, pra nuk është arkivuar dhe

nuk ka mbyllur veprimet, por i është dërguar përsëri shkresa mbas tre viteve po me të njëjtat kërkesa dhe nga i interesuari nuk janë paraqitur dokumentat ligjor sipas ligjit nr.133/2015 si dhe pikës 6 të VKM nr.222, datë 23.3.2016, “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj”, por për to nuk ka regjistër të veçantë ndjekje (*Më hollësisht trajtuar në faqet 22-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: ATP të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore:

a.për subjektet të cilat nuk kanë paraqitur dokumentat ligjore për plotësimin e dosjes me dokumentacion tekniko-ligjor, në mënyrë që të përfundojë procesi i vendimmarrjes përkatëse dhe ti arkivojë këto dosje sipas procedurave ligjore, duke nxjerrë përgjegjësinë përkatëse.

b.të ndjekë procedurat ligjore për plotësimin e regjistrave në mënyrë kronologjike e numerike sipas radhës që paraqiten qytetarët dhe të njoftojë ato për mos shprehjen e interesit dhe plotësimin e praktikave të dorzuara me mangësi dokumentare në numër e përmbajtje.

Brenda muajit Shkurt 2019

5.Gjetje: Në regjistrat e mbajtur gjatë vitit 2016, 2017 dhe viti 2018 mbi kërkesat, ankesat, informacionet për dosjet, është kostatuar se këto regjistra janë të pa vulosur, nuk përmbajnë numrin e fletëve, nuk përshkruhet se nga cili specialist është mbajtur, nuk kanë të mbushura kolonat përkatëse me të gjithë modalitetet e duhura, formati ka qenë në forma të ndryshme, sipas mendimeve individuale të specialistëve të protokollit, janë mbajtur me qindra nr. protokollit bosh dhe vazhdohet në numra rendore të tjerë. Konkretisht, regjistri i mbajtur në periudhën Qeshor - Tetor 2016, fillon me nr. rendor 6553 dhe vazhdon me nr. 6622 pra janë 69 nr. protokollit bosh, regjistruar një person në nr.6662 dhe vazhdon në nr.6689 dhe 6691 dhe përsëri ka numra bosh deri 6795. Pra, në total janë **104 vende bosh** ku mund të regjistrohen persona edhe po të kenë ardhur më vonë, rendi kronologjik nuk mbahet sipas radhës. Në rendin numerik(radhitja) të fletëve janë rreth 30 fletë të pambushura dhe janë mbajtur nr.protokollit bosh, të cilat bëhen në çdo kohë bazë dokumentare abuzimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Rregulloren e brendshme të ATP me nr.277, datë 10.10.2016 neni 6, pika 2 dhe neni 28 “Sektori i Protokollit” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: ATP të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësinë për situatën e krijuar,të ndjekë procedurat ligjore në përshtatshmëri me ligjet për regjistrat e protokollit,:

a. të ngrihet komision dhe të bëhen theme vendet bosh, duke i nxjerr ato(numrat rendor dhe fletët) jashtë funksionit, duke vënë shënimin e veçantë “Pavlefshme çdo shënim” me shënimin, pasqyruar këto në proces verbal, duke krijuar pengesën administrative për mospërdorimin e tyre si vende që mbartin veprime korruptive e plotësojnë interesa të veçanta të personave të interesuar.

b.të ndjekë numrat rendor dhe fletët në vijimësi në mënyrë kronologjike e numerike sipas radhës që paraqiten qytetarët.

Brenda muajit Dhjetor 2019

6.Gjetje: Dosja me nr.275, datë 28.03.2017 sipas Vendimit nr.493, datë 28.03..2017, të marrë nga ATP kostatohet se janë marrë informacionet nga ZVRPP Shkodër me nr.2651, datë 11.07.2016 ku figuron pronë “Shtet”, vertetim nga Gjykata e Rrethit Shkodër që nuk ka proces gjyqësor.

Pra, sipas dokumentacionit të pasur në dosje rezulton se mungojnë informacionet nga Agjencia e Legalizimit të pronave, nuk ka dokument nga Arkiva e shtetit apo nga kadastra e tokave.

Pra, dosja është e pa plotësuar me dokumentat përkatëse sipas kërkesave të nenit 36 ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” si dhe VKM nr.222, datë 23.03.2016 pika 3 dhe pika 13, për shpronësimin e pronës së qytetarit Asim Metani, Shkodër, për sipërfaqen 616m² në vlerën **5,238,521 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në faqet 220-226 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: ATP të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për plotësimin e dosjes sipas kërkesave të ligjit, duke njoftuar zyrtarisht qytetarin, duke nxjerrë përgjegjësinë për situatën e krijuar.

Brenda muajit Shkurt 2019

Gjetje 7: Nga ATP rezulton se është kryer një veprimtari e pamjaftueshme nga ana organizative, ashtu dhe nga ana kualitative për zbatimin e VKM nr.770, datë 12.11.2014, pika 1,2 dhe 3. Verifikimet e kryera kanë mbetur në fazën e konstatimeve të pathelluara dhe me gjetjen e rrugëve të bashkëpunimit me qarqet, bashkitë dhe ZVRPP-të për të operuar me shpejtësi sipas nevojës,

duke sjellë ndryshime të menjëhershme në nenet e VKM nr.770, datë 12.11.2014 “ Për kalimin në Fondin e Kompesimit Fizik, në Dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave të sipërfaqes së tokës bujqësore **prej 23368.8 ha** (Trajtuar në faqet 190-225 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së të marrë masa me strukturat përkatëse për periudhën e mbetur deri në mbyllje të procesit të trajtimit të pronave, për të saktësuar në mënyrë të qartë situatën e pronave të disponueshme dhe të përcaktuara sipas VKM nr.770, datë 12.11.2014 “ Për kalimin në Fondin e Kompesimit Fizik “, dhe të përcaktojë rrugë e forma të reja me qëllim që fondi i munguar prej **13055 ha** të plotësohet dhe të mos cënohet ecuria procesin e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave me sipërfaqe të tokës bujqësore.

Në vijimësi

Gjetje 8: Drejtoria e Shërbime të Brendshme në ATP, të marrë masa dhe të ndjekë shpenzimet e karburantit nga mjetet për transport të brendshëm dhe transport të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë rrethit. Duhet të llogariteshin drejt normativat e harxhimit të karburantit për 100 km të përshkuara, pasi në kryerjen e proces verbaleve kanë munguar specialistët e fushës së transportit. Konkretisht, kanë marrë pjesë shoferët përkatës të automjeteve për përcaktimin e harxhimit të karburantit për 100 km rrugë të përshkuar, ku rezulton se sipas proces verbaleve të mbajtura, normativat e llogaritura janë të pa pranueshme (Trajtuar në faqet 190-235 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtoria përgjegjëse të marrin masat përkatëse për ndjekjen e shpenzimeve të karburantit nga mjetet për transport të brendshëm dhe transport të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë rrethit, duke rishikuar normativat e harxhimit të karburantit për 100 km të përshkuara, duke argumentuar normën e harxhimit me shërbimet teknike të kryera, kohën e përdorimit dhe shkalla e amortizimit konkret të mjetit, etj.

Në vijimësi

9. Gjetje: Nga ana e ATP Tiranë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, pika 3, gërma “d”, lidhur me mungesën e dokumentacionit ligjor për kohën e shpronësimit dhe përcaktimin e zërit kadastral, ku nga verifikimi i hartës dixhitale, *harta që është më e afërme kohën e shpronësimit*, konstatohet se pronat në fjalë janë jashtë vijave kufizuese (vija e verdhë) të qyteteve, pra është tokë “Arë”.

Kështu, në **9 raste**, për shumën 283,626,509 lekë, sipas vendimeve të ATP-së për kompensim financiar/fizik me numër: nr. 253, datë 01.12.2016; nr. 488, datë 28.03.2017; 460, dt.28.03.2017; 179, dt.01.12.2016; 529, dt.25.04.2017; 257, dt.01.12.2016; 496, dt.28.03.2017; 45, dt.17.02.2017; 55, dt.17.02.2017, konstatohet se në dosje mungonte dokumentacioni për të vërtetuar kryerjen e shpronësimit, kohën si dhe zërin kadastral në kohën e shpronësimit dhe nga verifikimi i hartës dixhitale, konstatohet se pronat në fjalë janë jashtë vijave kufizuese (vija e verdhë), pra janë në zërin kadastral tokë “Arë”.

Vlera prej 283,626,509 lekë, e cila përfaqëson diferencën ndërmjet vlerës së llogaritur për kompensim financiar e fizik të sipërfaqes “Truall” dhe vlerës që duhej llogaritur sipas çmimit të tokës “Arë”, rrjedhimisht nuk është zbatuar procedura e plotë e rillogaritjes dhe mosargumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar, në moszbatim të pikës 3, gërma “d” të VKM nr. 223, datë 23.3.2016 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 95-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa duke nxjerrë përgjegjësinë për të ardhmen, të mos procedojë me vlerësimin dhe marrjen e vendimeve të kompensimit financiar dhe fizik, pa kryer një ballafaqim ndërmjet hartës më të afërt me kohën e shpronësimit, ku harta duhet të jetë e miratuar nga organe shtetërore kompetente, të ketë të përcaktuar vijën kufizuese (vijën e verdhë), pozicionimin e pronës së kompensuar në raport me këtë vijë, ose të ketë të shprehur saktësisht dhe shprehimisht zërin kadastral të pronës, dokumentacioni që administrohet fizikisht me hartën dixhitale në funksionim dhe pa një përputhje të plotë mes tyre.

Të respektohet procedura e plotë e rillogaritjes dhe argumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar.

Në vijimësi

10. Gjetje: Nga ana e ATP Tiranë, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, pika 1,2,3,4,5 të nenit 6 dhe pika 2 e nenit 7, lidhur me vendimin e ATP nr.238, datë 01.12.2016, ku sipas dokumentit të shpronësimit zëri kadastral i origjinës është “Pemishte” (tokë “Arë”), në një kohë kompensimi është dhënë për tokë “Truall”.

Kështu, në **1 rast**, vlerësimi i pronës për kthim është më i lartë se vlerësimi i pronës së lënë për kompensim, dhe subjekti konsiderohet i kompensuar dhe vlera e lënë për kompensim prej 25,201,890 lekë, në kushtet kur zëri kadastral në kohën e shpronësimit ka qenë tokë “Arë” (Pemishte) dhe është vlerësuar “Truall”, rrjedhimisht nuk është zbatuar procedura e plotë e rillogaritjes dhe nuk është kryer argumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar (*Më hollësisht trajtuar në faqet 80-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa për vijimësinë, të mos procedojë me vlerësimin dhe marrjen e vendimeve të kompensimit financiar dhe fizik, në zërin kadastral “Truall”, në kushtet kur dokumentet e shpronësimit përcaktojnë zërat kadastrale: tokë “Arë”, “Ullishte”, “Pemishte”, “Vreshta”. Të respektohet procedura e plotë e rillogaritjes dhe argumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar për rastin e trajtuar.

Në vijimësi

11.Gjetje: Nga ana e ATP Tiranë, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, neni 36, lidhur me bashkërendimin e veprimtarisë së ATP-së me institucionet e tjera, veprimtaria e të cilëve ka lidhje me procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës.

Kështu, në të gjitha rastet (**52 raste**), nuk ndodhet dokumentacion në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës në dosjet e audituara sipas vendimeve të ATP-së, lidhur me bashkërendimin e veprimtarisë dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të ATP Tiranë me: ALUIZNI, Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor (Bashkia, Qarku) (*Më hollësisht trajtuar në faqet 63-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa për të ardhmen të mos procedojë me vlerësimin dhe marrjen e vendimeve të kompensimit financiar dhe fizik, në kushtet kur në dosjen e kompensimit mungon dokumentacioni në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, lidhur me bashkërendimin e veprimtarisë dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të ATP Tiranë me:ALUIZNI, Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor (Bashkia, Qarku) dhe institucione të tjera, veprimtaria e të cilave ka lidhje me procesin e kompensimit dhe kthimit të pronës.

Në vijimësi

12. Gjetje: Nga ATP Tiranë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, neni 6, pika 6, lidhur me vlerën e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, duke përfshirë vlerën e pronës së përfitur nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfitur më parë.

Kështu, ATP Tiranë, në të gjithë rastet (**52 raste**), në dosjet e audituara sipas vendimeve për kompensim financiar/fizik, ka kryer kompensimet financiare në mungesë të dokumentacionit vërtetues të faktit të mospërfitimit nga vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, kompensime të cilat duhej të zbriteshin nga shuma e përlllogaritur për kompensim.

Në këto dosje mungonin vërtetimet negative për mospërfitim nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfitur më parë (*Më hollësisht trajtuar në faqet 56-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa për të ardhmen të mos procedojë me vlerësimin dhe marrjen e vendimeve të kompensimit financiar dhe fizik, në mungesë të dokumentacionit vërtetues të faktit të mospërfitimit nga vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, kompensime të cilat duhej të zbriteshin nga shuma e përlllogaritur për kompensim.

Në vijimësi

13. Gjetje: Bazuar në programin e auditimit për t'u shkuar problematikave në periudhat e mëparshme deri në origjinë, u audituan vendimet e KKKPP-ve në qarqe, prej ku konstatohet:

-Nga ana e ish- Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve (KKKPP), ZRKKP, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "*Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve*", neni 6, lidhur me shpërblimin e dhënë për pronat në kohën e shpronësimit.

Kështu:

-KKKPP Shkodër, në 1 rast, sipas vendimit nr. 259, datë 16.06.1994 (Vendimi ATP nr. 473, datë 28.03.2017), ka njohur, kthyer dhe lënë për kompensim, një sipërfaqe të përgjithshme prej 1908.9 m², prej së cilës 115 m² pa shpërblim dhe 1793.9 m² me shpërblim, vendimi 173, datë 29.12.1962 i Komitetit Ekzekutiv Shkodër, për shumën 88104 lekë, e cila nuk duhej trajtuar nga KKKPP Shkodër. Prona e vlerësuar me hartën e vlerës së pronës konstatohet një diferencë prej 20,521,195 lekë, vlerë prone të kthyer dhe pagesë kompensimi, e kryer në kundërshtim me ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993 "*Per kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronareve*", neni 6.

-KKKPP Tiranë, në 4 raste, sipas nr. 572, datë 25.07.1994, nr. 502, datë 28.06.1994, 414, datë 22.05.2014, nr. 274, datë 17.03.1994, nr. 780, datë 13.10.1994, kanë marrë vendim për njohje, kthim dhe lënë për kompensim, sipërfaqe "Truall", në kushtet kur në dosje mungon dokumentacion hipotekor, kadastral, ky dokumentacion është pa sipërfaqe, mungojnë dokumentat e shpronësimit dhe nuk vërtetohet nëse shpronësimi është bërë më apo pa shpërblim.

Në kushtet e mësipërme vendimet e mësipërme nuk duhej të ishin marrë nga ish-KKKPP pronave (*Më hollësisht trajtuar në faqet 66-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa për të ardhmen, të mos procedojë me marrjen e vendimeve të reja për njohjen, kthimin dhe kompensimn financiar dhe fizik, të pronës, në kushtet kur:

-pronat e përfituara janë, si rezultat i zbatimit të ligjit nr.108, datë 29.8.1945, për "*Reformën agrare*", me ndryshimet e mëvonshme.

-shpronësimet kundrejt një shpërblimi të drejtë, sipas përcaktimeve të kohës.

-pronat që i janë dhuruar shtetit, veprim për të cilin ka dokumente zyrtare.

Në vijimësi

14.Gjetje:Në 45 raste, sipas urdhër shpenzimeve përkatëse janë kryer shpenzime në shumën totale 76,302,843 lekë, me objekt "*Paga bazë, shtesë page, raporte mjekësore+honorare*", në kredi të punonjësve të ATP-së, sipas listë-pagesave bashkëlidhur urdhër-shpenzimeve, Viti 2017, në mungesë të listë-prezencave bashkëlidhur të nëshkruar nga personat kompetentë, sektori burimeve njerëzore i caktuar sipas ligjit dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, pika 69 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 62-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1.Rekomandimi: ATP Tiranë (Sektori i Financës) të marrë masa, të analizojë problemet e ngritura duke nxjerrë përgjegjësinë përkatëse dhe në të ardhmen të mos pranojë e të mos kalojë urdhër-shpenzime me objekt "*Paga bazë, shtesë page, raporte mjekësore + honorare*", në kredi të punonjësve të ATP-së, në mungesë të listë-prezencave të nëshkruar nga personat kompetentë, sektori burimeve njerëzore i caktuar sipas ligjit dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

Në vijimësi

14.Gjetje:Në 10 raste, nga auditimi me zgjedhje për vitin 2017, sipas urdhër shpenzimeve përkatëse, janë kryer shpenzime në shumën totale 16,161,729 lekë, me objekt "*Blerje pajisje, kryerje shërbime, riparime etj.*", në kredi të operatorëve ekonomikë, marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve, në mungesë të specifikimetve teknike të përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit, si për rastet e zbatimit të kontratrave për blerje pjesë këmbimi, blerje kancelari e shtypshkrime, etj., mbi bazën e të cilave komisioni duhej të kryente verifikimin fizik të aktiveve në sasi, cilësi dhe çmim. Këto dokumente nuk ndodhen në dosje, kështu që komisioni realisht nuk ka kryer verifikim sipas kushteve në kontratat e lidhura.

Sipas proces-verbaleve të marrjes në dorëzim, nuk rezulton të jenë kryer verifikime, duke përshkruar procedurën e kryer, përshkrimin e veprimeve të kryera, krahasimet e faktit me

dokumentacionin e ofertës fituese, si certifikata origjinale dhe cilësie, kryerjen e provave me zgjedhje, fleta analize laboratorike, garanci malli, etj.

Vepruar në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, pikat 42-50 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 96-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1.Rekomandimi: ATP Tiranë (Sektori i Financës) të marrë masa për të ardhmen të mos pranojë e të mos kalojë urdhër-shpenzime në transfertat në kredi të operatorëve ekonomikë që do kryej për blerje mallra, kryerje shërbime, riparime, etj.”, , në kushtet kur konstatohet se proces verbalet e marrjes në dorëzim janë kryer formalisht dhe nuk rezulton të jenë kryer verifikimet përkatëse sipas specifikimeve teknike.

-Të zbatohet procedura ligjore, duke bërë përshkrimin e veprimeve të kryera, krahasimet e faktit me dokumentacionin e ofertës fituese, si certifikata origjinale dhe cilësie, kryerjen e provave me zgjedhje, fleta analize laboratorike, garanci malli, etj.

-Të mos pranohen proces-verbalet në mungesë të trajtimit hollësisht në përmbajtje dhe në formë prej tyre, të specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit, mbi bazën e të cilave komisioni duhej të kryejë verifikimin fizik të aktiveve në sasi, cilësi dhe çmim.

Në vijimësi

16.Gjetje: Në 9 raste (Vendim nr.288, datë 01.12.2016, Vendim nr.167, datë 01.12.2016, Vendim nr.216, datë 01.12.2016, Vendim nr.643, datë 10.07.2017, Vendim nr.124, datë 10.10.2016, Vendim nr.102, datë 10.10.2016, Vendim nr.163, datë 01.12.2016, Vendim nr.458, datë 28.03.2017 dhe Vendim nr.247, datë 01.12.2016) u konstatua se ATP ka bërë përlllogaritje të gabuar të kompensimit të subjekteve të shpronësuara në vlerën totale prej *314,043,899 lekë mbi bazën e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të bëra për zërin kadastral “Truall”, dhe jo sipas zërit kadastral që prona ka patur në kohën e shpronësimit*. ATP nuk ka vlerësuar financiarisht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka patur prona në kohën e shpronësimit, nuk është identifikuar lloji i pasurisë në kohën e shpronësimit (mund të ketë qenë tokë bujqësore, pyll, kullotë etj.). Vendimet për kompensim janë marrë në mungesë të dokumentit të shpronësimit për sipërfaqet e kompensuara mbi bazën e të cilit do të përcaktohej koha e shpronësimit, si dhe zëri kadastral i pronës në kohën e shpronësimit. Edhe në rastet kur ATP në pamundësi për të verifikuar kohën e saktë të shpronësimit, pa të drejtë, i është referuar hartës së viteve 1937-1938, nga verifikimi i së cilës, realisht ka qenë i pamundur përcaktimi i zërit kadastral. Veprime në kundërshtim me pikën 1-5 të nenit 6 Ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar

Në 1 rast (Vendim nr.163, datë 01.12.2016) u konstatua se; si pasojë e moszbatimit të procedurës së rregullt ligjore të vlerësimit financiar të vendimeve për kompensim, subjektet e shpronësuara **janë kompensuar fizikisht më tepër me sipërfaqen totale prej 71408m2 (7,14 ha) arë** Veprime në kundërshtim me pikën 1-4 të nenit 6 Ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqet 40-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1.Rekomandimi: ATP, Tiranë, të marrë masa që për të gjitha rastet e pronës së njohur për kompensim me vendim përfundimtar, vlerësimi financiar të bëhet në bazë të zërit kadastral që ka patur prona në kohën e shpronësimit, duke ndjekur procedurën e rregullt ligjore për identifikimin e llojit të pasurisë në kohën e shpronësimit.

16.2.Rekomandimi: Për rastet kur hasen vështirësi objektive në përcaktimin e zërit kadastral, ATP të kryej hetime administrative në bashkëpunim me të gjitha institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi për procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës me qëllim mbledhjen e fakteve dhe pronave që japin siguri të arsyeshme për marrjen e një vendimi të drejtë.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetje: Në 2 raste (Vendim nr. 467, datë 28.03.2017 dhe Vendim nr.100, datë 10.10.2016) u konstatua se ATP, Tiranë, ka marrë vendime për kompensim financiar në vlerën 94,762,840 lekë dhe kompensim fizik me sipërfaqen 45227.5m2 arë, thjesht mbi bazën e një shkrese pa vulë, që i

referohet vendimit të pretenduar të ish-KKKP. Këto shkresa nuk kanë; *emërtimin Vendim, nuk kanë nr. dhe as datën e vendimit të pretenduar, si dhe mungon pjesa arsyetuese*. Pra, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me vendim të KKKP, pasi shkresa nuk ka elementët e formës dhe përmbajtjes së vendimit e mbi të gjitha i mungon vula si mjet identifikues dhe ligjërues i vendimeve të marra nga ish-KKKP dhe pjesa arsyetuese. Për pasojë, vendimet për kompensim financiar të bërë nga ATP, në mungesë të vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, *pra dokumentit ligjor mbi të cilin ATP mundet të jap vendim për kompensimin financiar, vlera prej 94,762,840 lekë, do të konsiderohet si efekt financiar negativ në fondin e kompensimit të ish-pronarëve*. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 38-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

kërkesat e formës dhe përmbajtjes të përcaktuara në nenin 99 dhe 100 të Ligjit 44/2015.

17.1.Rekomandimi: ATP, Tiranë, për të gjitha rastet ku konstatohet se mungon vendimi përfundimtar ose nuk plotësohen kërkesat e formës dhe elementëve të tjerë të detyrueshëm të aktit administrativ (*p.sh mungesa e nënshkrimit, vulës, pjesa arsyetuese, dispozitivi etj.*), të marrë masa që të rrëzojë me vendim kërkesat për kompensim financiar ose kompensim fizik.

17.2.Rekomandim: ATP, Tiranë, të marrë masa që në bashkëpunim me institucionet kompetente për këtë proces të ngrej grup pune për kryerjen e një hetimi administrativ në lidhje me këtë çështje. Nëse nuk vërtetohet se vendimet mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi financiar janë të vlefshme dhe se nuk plotësojnë elementët e formës dhe të përmbajtjes të një akti administrativ (neni 108/a/iii i ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”), atëherë të rillogarisë vlerën financiare të përcaktuara në Vendim nr.467, datë 28.03.2017 dhe Vendim nr.100, datë 10.10.2016, **sepse nuk plotësojnë kërkesat ligjore për përmbajtjen e elementëve të detyrueshëm të aktit.**

Menjëherë dhe në vijimësi

18.Gjetje: Në 6 raste (*Vendim nr.118, datë 10.10.2016, Vendim nr.288, datë 01.12.2016, Vendim nr.112, datë 10.10.2016 dhe Vendim nr.130, datë 10.10.2016, Vendim nr.643, datë 10.07.2017, Vendim nr.649, datë 10.07.2017*), Agjencia e Trajtimit të Pronave, Tiranë, ka bërë rivlerësim të vendimeve administrative të formës së prerë të cilët kanë vendosur kompensimin financiar duke rritur vlerën e kompensimit për shkak të çmimit më të lartë të truallit për m² në një rast në vlerën 7,428,000 lekë, dhe duke e ulur vlerën e kompensimit në disfavor të pronarëve në rastet e tjera, si rezultat i çmimit më të ulët të pronës në disa Zona Kadastrale. Ky veprim bie në kundërshtim të Vendimit nr.1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese ku citohet “Gjykata Kushtetuese, lidhur me dispozitat që parashikojnë që vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi, vlerëson se ato ngrenë çështjen e “pritshmërisë legjitime”, por sipas ligjit nuk do t’i nënshtrohen rivlerësimit.” dhe qëndrimin të Komisionit të Venecias nr.861/2016, CDL-AD (2016) 023, i cili shprehet “Vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi... nuk do t’i nënshtrohen rivlerësimit sipas ligjit nr.133/2015” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 60-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1.Rekomandimi: Agjencia e Trajtimit të Pronave, Tiranë, të marrë masa që në të gjitha rastet e vlerësimeve financiare të mos bëjë rivlerësimin e vendimeve të formës së prerë (titujve ekzekutiv), ku është vendosur kompensimi financiar për një pjesë të sipërfaqes së njohur për kompensim, nga i cili mundet të rezultojnë diferenca në vlerë monetare të kompensimit financiar në favor të padrejtë të ish-pronarëve ose në disfavor të tyre, si pasojë e ndryshimit të çmimeve të pronës në varësi të Zonave Kadastrale. ATP, në raste të tilla, të bëjë vlerësimin financiar vetëm për pjesën e mbetur për kompensim, në zbatim të Vendimit nr.1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe qëndrimin të Komisionit të Venecias nr.861/2016, CDL-AD (2016) 023.

18.2.Rekomandimi: Agjencia e Trajtimit të Pronave, Tiranë, të marrë masa që në aplikimin e metodologjisë së përcaktuar në nenet 6 dhe 7 të Ligjit nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar, të mos përdorë standarde të ndryshme në vlerësimin e vendimeve përfundimtare, por të ruaj koherencë dhe paanshmëri në procedurën e kompensimit, me qëllim vlerësimin e drejtë financiar, në mënyrë që

mos të privohet asnjë ish-pronar nga e drejta e pronës dhe mos të favorizohen padrejtësisht ish-pronarë të tjerë.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.Gjetje:Në 13 raste, ATP Tiranë nuk ka kërkuar informacion nga ZVRPP, Këshilli i Qarkut (DAMT), apo organet e tjera përkatëse të vetëqeverisjes vendore, nëse trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar kanë të regjistruar apo ka përfituar tokë bujqësore sipas Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”. Gjithashtu nuk është kërkuar informacion dhe nuk ka ndonjë vërtetim nga Gjykatat përkatëse nëse në lidhje me çështjen ka apo jo ndonjë vendim të formës së prerë ,apo është në proces gjyqësor për pronën e përfituar me vendim të ish-KKKP. Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” *(Më hollësisht trajtuar në faqet 66-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa që në të gjitha rastet të kërkojë informacion nga ZVRPP, Këshilli i Qarkut (DAMT), apo organet e tjera përkatëse të vetëqeverisjes vendore nëse trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar kanë të regjistruar apo ka përfituar tokë bujqësore sipas Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, si dhe të kërkojnë informacion nga Gjykatat përkatëse nëse në lidhje me çështjen ka apo jo ndonjë vendim të formës së prerë apo është në proces gjyqësor për pronën e përfituar me vendim të ish-KKKP.

Në vijimësi

20.Gjetje: Në 7 raste, ATP Tiranë mbi bazën e deklaratës noteriale të përfaqësuesit me prokurë, ka marrë të mirëqenë deklaratën e heqjes dorë nga e drejta e parablerjes, në një kohë që nuk ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, pranë Ministrisë së Financave, për objektet të cilave u është njohur e drejta e parablerjes, nëse janë privatizuar apo jo nga këta persona. ATP, duhet që domosdoshmërisht të kërkonte këtë informacion në mënyrë që të evitonte kompensimin e padrejtë të subjekteve të cilat mundet të kenë privatizuar këto objekte, nga ushtrimi i së drejtës së parablerjes, pavarësisht faktit që kjo e drejtë apo kontrata e privatizimit mundet të mos jetë regjistruar në ZVRPP. Veprime në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” *(Më hollësisht trajtuar në faqet 38-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1.Rekomandimi: Agjencia e Trajtimit të Pronave, Tiranë, të marrë masa që për të gjitha rastet e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e parablerjes, të kërkojë informacion nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, pranë Ministrisë së Financave nëse objektet shtetërore për të cilat u është njohur e drejta e parablerjes subjekteve të shpronësuar janë privatizuar apo jo nga këta persona..

Në vijimësi

21.Gjetje:Në 2 raste ka pasur mangësi në dokumentacionin e administruar në dosje respektivisht në dosjen e subjektit aplikues T. M. me adresë në fshatin Pîrg të rrethit të Korçës si edhe në dosjen e subjektit për kompensim E. S., përfaqësues ligjor i trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar R. D. S. ku mungonte informacioni i ZVRPP.

-Në **28 raste**, nga auditimi me risk i më tepër se **250 dosjeve** me kompensim financiar në zbatim të nenit 3/a dhe 3/b të VKM nr.223 datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, nuk është përcaktuar asnjë metodologji nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, lidhur me interpretimin e pikës 3, dhe as i është përcjellë ndonjë material Ministrisë së Drejtësisë për këtë qëllim, *kërkesë kjo e nenit 26 “Agjencia e Trajtimit të Pronave” dhe neni 37 “Aktet nënligjore” të ligjit nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.* Kjo ka shkaktuar një gabim në mënyrën e llogaritjes që ka cuar në devijimin e disbursimit ose mosdisbursimit të fondeve financiare në drejtim të **28 subjekteve** në vlerën totale **prej 46,635,813 lekë**, të konstatuara gjatë auditimit përkatësisht; në vlerën totale +23,603,436 lekë më shumë në favor të 13 subjekteve si edhe -23,032,377 lekë më pak në drejtim të 14 subjekteve të tjera të kompensuara dosjet e të cilëve u kontrolluan gjatë periudhës së auditimit. Pra, nga të dhënat e mësipërme duket se ka një keqinterpretim të ligjit 133/2015 dhe akteve nënligjore të përmendura më lart. Në lidhje me këto gjetje, ka një interpretim të gabuar të ligjit 133/2015, nenit 6 dhe 7 të

tij; të VKM 223/2016, nenit 3 dhe 4 të saj si edhe të vendimit nr.1 datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë e cila i referohet në pikën 45 nenit 1 të Protokollit nr.1 të GJEDNJ-së. Po kështu, të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni i Venecias, i cili në opinionin e tij mbi zbatimin e ligjit shprehet: *“Vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi, por që ende nuk janë ekzekutuar, pa dyshim që ngrenë çështjen e “pritshtërisë legjitime” dhe nuk do t’i nënshtrihen rivlerësimit sipas ligjit nr.133/2015”*. Në këtë kuptim, nuk mund të rivlerësohen as vendimet administrative të ekzekutuara financiarisht dhe një akt administrativ kur nuk ka specifikime konkrete për pjesë të vecanta të tij, ngelet i zbatueshëm ashtu siç është në të gjitha elementët e tij. Nëse do të merrnim një shembull nga banka, që është institucioni më i plotë mbi marrëdhëniet financiare mes subjekteve të një shoqërie, nëse një subjekt ka shlyer një pjesë të detyrimit me kushte të caktuara dhe i ka mbetur një pjesë tjetër e detyrimit pa u shlyer, në kushtet e reja që mund të paraqiten përballë palës kreditore dhe debitore, të fillojë edhe njëherë rillogaritja e detyrimeve të likuiduara në kushtet e mëparshme të shlyerjes së detyrimit nga pala debitore. Një llogjikë e një veprimtarie të tillë antifinanciare nga ana e ATP është një keqinterpretim i ligjit i cili në llogjikën e tij kërkon që kur të rillogaritet kompensimi financiar të merret parasysh nëse ka pasur ndonjë lloj kompensimi apo shlyerje financiare të mëparshme për një sipërfaqe të caktuar e cila duhet të zbritet nga sipërfaqja e përgjithshme e caktuar për kompensim për subjektin nga vendimet e mëparshme. Nisur nga kjo llogjikë financiare nuk pranohen observacionet mbi subjektet e përmendura më sipër. Për të konkretizuar qëndrimin e Komisionit të Venecias kur thotë *“Vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi,…”* me kuptimin e një vendimi të një akti administrativ si *“vendim përfundimtar”*, në të gjitha gjetjet, kemi cituar nenin 5/17 të Ligjit 133/2015 i cili thotë shprehimisht: *“Vendim përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor,…”* dhe ATP nuk mund të konsiderohet një autoritet më i lartë, por si një vazhdim i AKKP-së, si institucion i bazuar në Ligjin 133/2015 dhe aktet administrative për të cilat ne po diskutojmë janë ndërmarë ose nga AKKP ose nga vetë ana e ATP-së, në disa raste (*Më hollësisht trajtuar në faqet 155-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa, që në të gjitha rastet e vlerësimeve financiare të mos bëjë rivlerësimin e vendimeve të formës së prerë (titujve ekzekutiv) të AKKP, ku është vendosur kompensimi financiar për një pjesë të sipërfaqes së njohur për kompensim, nga i cili mundet të rezultojnë diferenca në vlerë monetare të kompensimit financiar në favor të padrejtë të ish-pronarëve, ose në disfavor të tyre, si pasojë e ndryshimit të çmimeve të pronës në varësi të Zonave Kadastrale, por të bëjë vlerësim për pjesën e mbetur të kompensimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje: Nga verifikimi i kryer i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga grupi i auditimit u konstatua se Vendimi nr.484, datë 03.12.2015 për tjetërsimin e oborrit në përdorim, me sipërfaqe 500m², në favor të B. P., është dhënë në kundërshtim me pikat 5 dhe 8 të VKM nr.578, datë 29.08.2012 *“Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”*, i ndryshuar, si dhe nenin 25/c të Ligjit nr.33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, i ndryshuar për arsytet si mëposhtë:

1. objekti është ngritur mbas datës 10.08.1991,
2. nuk mund të vërtetohet se pronat nuk janë transferuar në inventarin e pronave të organeve të qeverisjes vendore, në përputhje me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 *“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”*, të ndryshuar, për shkak se nuk ka përfunduar procesi i inventarizimit,
3. sipërfaqja e tokës nuk rezulton fizikisht e lirë sepse në sipërfaqen prej 500m² truall e miratuar si oborr në përdorim në favor të B. P. rezultojnë të ndodhen edhe 2 (dy) objekte të tjera (pa leje).
4. regjistrimi në ZVRPP Tiranë i Vendimit të Gjykatës nr.2492, datë 13.07.1993 *“Për vërtetimin e faktit juridik”*, mbi bazën e të cilit është marrë Vendimi nr.484, datë 03.12.2015 për tjetërsimin e oborrit në përdorim, me sipërfaqe 500m², në favor të B. P., është bërë në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në kundërshtim me nenin 45/2 të Ligjit nr.33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqet 155-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1.Rekomandimi: Agjencia e Trajtimit të Pronave, Tiranë të marrë masa për të kërkuar pranë ZVRPP Tiranë kufizimin e pasurisë regjistruar me Vendim të ATP nr.484, datë 03.12.2015 “Për tjetërsimin e oborrit në përdorim”, me sipërfaqe 500m2, të dhënë në favor të B. P., deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga organet kompetente.

Menjëherë

23.Gjetje: ATP Tiranë gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit, për disa vite rresht rezultoi komisioni i inventarizimit ka kaluar në mënyrë fiktive pa patur gjendje në magazinë në vlerë përdorimi një sasi karburanti për mospërmbushje të detyrimeve të kontratës nr. ref.001, nr.6 e prot datë 2.09.2009. Sipas vendimit të Gjykatës Apelit nr.454, datë 18.02.2014, Kolegji Civil çmon në çështjen objekt gjykimi pala e paditur ka përfituar shumën *4,466,870 lekë* dhe nga ana e saj nuk është dhënë malli(karburanti palës paditëse(ATP) sipas kontratës. Për zbatimin e vendimit të mësipërm nga ATP, nuk ka veprime të mëtejshme dhe deri në periudhën e auditimit dhe sasia e mallit në vlerën e mësipërme nuk është kthyer.

Pasojat e mësipërme, vijnë si rezultat i lidhjes me kushte diskriminuese të kontratës, ku nga ana e institucionit është zbatuar likuidimi i menjëhershëm dhe paraprak i vlerës së mallit(karburantit) bazuar në dorzim të tollave me vlerë fizike (letra me vlerë). Në fakt, likuidimi duhej bërë për çdo rast vetëm pasi sipas nevojës së institucionit është konsumuar karburanti për gjithë kohën e vlefshmërisë së kontratës, fonde të cilat parashikohen në buxhetin vjetor. Mos zbatimi i këtyre normave të blerjes ka çuar në humbjen e karburantit me vlerën e paraqitur, gjë të cilën nuk mund të ekzekutojë as me rrugë përmbartimore si dhe nuk ka rrugë ligjore për ta kaluar në rezultat (*Trajtuar në faqet 199-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i përfaqësimit Ligjor mbështetur në ligjin nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr.30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të shqyrtojë përgjegjësinë direkte dhe indirekte të punonjësve që kanë krijuar këtë dëm financiarë, të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet dhe *të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim kërkimin e arkëtimit të shumës prej 4,466,870 lekë nga subjekti përfitues dhe të sistemojë veprimet e diferencave gjatë kryerjes së inventarit të vitit 2018.*

Menjëherë

24. Gjetje: Në 20 raste, për vitin 2017, sipas urdhër shpenzimeve nr. 6,7,8 datë 24.01.2017; nr. 14,15,16, datë 30.01.2017; nr. 27/1,28,29 datë 14.02.2017; nr. 38,39,40 datë 21.02.2017; nr. 52,53,54 datë 16.03.2017; nr. 69,70,71 datë 06.04.2017; nr. 97,98, datë 09.05.2017; nr. 146,147, datë 22.06.2017; nr. 172,173,174, datë 26.07.2017, u konstatua se janë kryer shpenzime në shumën *2,464,000 lekë*, në kredi të 12 punonjësve të ATP(*cituar në raportin Përfundimtar për çdo rast përfitimi të paligjshëm*), për udhëtime dhe dieta brenda vendit, shpenzime bazuar në urdhra të paligjshëm, për bashkëpunimin me institucionet e treta si ZVRPP Malësi e Madhe, ZVRPP Shkodër, Bashkia Malësi e madhe (Njësitë Administrative përkatëse), Bashkia Shkodër, Prerrefektura Shkodër, Këshilli i Qarkut Shkodër, ZVRPP Vorë, ZVRPP Sarandë, Bashkia Vlorë, Bashkia Sarandë, Bashkia Himarë (Njësitë Administrative përkatëse), Prerrefektura Vlorë, Këshilli i Qarkut Vlorë, për të verifikuar Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi që i përkasin këtij Qarku, referuar pretendimeve për njohje pronësie të trashëgimtarëve të subjekteve të shpronësuar të cilët kanë pretendimet e tyre pranë ATP, ose me qëllime marrje përgjigje nga këto institucione.

Punonjësit e ATP Tiranë, sipas borderosë së dietave janë paguar punonjës, me dokumentacione të parregullt, urdhër shërbime të pafirmosura nga personat udhëtues dhe urdhërues, fatura hoteli të pafirmosura nga personat udhëtues, etj, në kundërshtim me VKM 329, datë 20.04.2016 “Për disa ndryshime në vendimin nr.997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar) (*Më hollësisht trajtuar në faqet 117-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,450,000 lekë, përfituar në mënyrë të paligjshme dhe pa dokumente nga punonjës të ATP-së(*cituar në raportin Përfundimtar për çdo rast përfitimi të*

paligjshëm), e cila përfaqëson 20 raste kryerje shpenzime për udhëtime dhe dieta brenda vendit, në kredi të 10 punonjësve, në rast të kundërt, shuma të likuidohet nga personat përgjegjës, si më poshtë:

-O. Rr.	264,000 lekë
-E. L.	242,000 lekë
-E. B.	286,000 lekë
-S. M.	286,000 lekë
-A. M.	242,000 lekë
-E. M.	22,000 lekë
-E. M.	22,000 lekë
-E. Ll.	22,000 lekë
-S. T.	22,000 lekë
-T. L.	22,000 lekë

Brenda muajit Mars 2019

25. Gjetje: Në 1 rast, nga auditimi me zgjedhje për vitin 2017, sipas urdhër shpenzimit nr. 80, datë 13.04.2017, janë kryer shpenzime në shumën 600,000 lekë, me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave PROJ.GIS”, në kredi të operatorit ekonomik “C. P. shpk”, kushtet kur fatura tatimore është një përmbledhje dhe nuk përmban zërat e shpenzimeve sipas listës së specifikimit dhe nuk përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës dhe të tjera të dhëna të nevojshme që t’i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative

Shuma e mësipërme prej **600,000 lekë është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**. Sa sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, pika 36 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 93-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **600,000 lekë, prej përfituesit të paligjshëm”C. P. shpk”**, (duke kryer ndalesë nga pagesat në vijim)e cila përfaqëson “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave PROJ.GIS”, në kushtet kur fatura tatimore është një përmbledhje dhe nuk përmban zërat e shpenzimeve sipas listës së specifikimit dhe nuk përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, nuk përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës dhe të tjera të dhëna të nevojshme që t’i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative, në rast të kundërt, shuma të likuidohet nga personat përgjegjës.

Brenda muajit Mars 2019

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, **nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues)**, të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë administrative dhe ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit, si më poshtë:

1.Gjetje: Janë krijuar detyrim të ATP në vlerën prej **19,547,981 lekë**, për ndërprerjen e njëanshme të marrëdhënieve të punës dhe të pagës së 22 punonjësve të larguar (paguar në periudhën e auditimit), provuar me vendimet gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, sipas tabelës aneks nr 1.,vlerë e cila përbën dëm ekonomik i paarkëtueshëm për buxhetin e shtetit, duke krijuar pagesa të dubluara për një vend pune, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, me ligjin nr.7961, datë 12.

07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me VKM nr.50, datë 5.2.2014 “Për Miratimin e Strategjisë për Parandalimin e Shlyerjeve të Detyrimeve të Prapambetura e të Planit të Veprimit”, Detyrimet dhe Likuidimet për Largimet nga Puna të paguara nga buxhetet e viteve deri 30.06.2016” deri më 1.07.2018, në bazë të pikës 12 të VKM nr.256, datë 13.04.2010 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AKKP”, pikës 13 të VKM nr.221, datë 23.03.2016 “Për Mënyrën e Organizimit dhe Funksionimit të ATP, dhe të nenit 38, Rregulloren “Për Organizimin e Punës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 4793, datë 02.07.2008, aktualisht në fuqi, sipas periudhave përkatëse të ushtrimit të detyrës mbajnë përgjegjësi nëpunësi autorizues, Drejtoria Juridike dhe nëpunësi zbatues i buxhetit financës (Trajtuar në faqet 190-227 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Mbështetur në ligjin nr.8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe ngrejë grup pune për të analizuar shkaqet dhe nxjerrur përgjegjësitë direkte për dëmin e shkaktuar në vlerën prej 19,547,981 lekë të pagës së 22 punonjësve të larguar.

Menjëherë e në vijimësi

2.Gjetje: ATP Tiranë ka kryer padrejtësisht ndërprerjen e njëanshme të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, provuar me vendimet gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, sipas tabelës aneks nr.1, duke krijuar detyrim ndaj zyrave të përbarimit në vlerën prej 1,227,223 lekë, tarifa përbarimore nga për pagesat e pagave të 22 punonjësve të larguar (paguar realisht në periudhën e auditit),vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, pasi janë pagesa krejt të panevojshme . Zyrave të Përbarimit i kanë kërkuar padrejtësisht katë shuma gjoja në zbatim kreut III, pika 2 dhe 5 e udhëzimit nr.385/7, datë 28.06.2017 “për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat”. Ky veprim përbën shkelje të kodit etik dhe disiplinës financiare për përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore, sepse vetë institucioni ka të qartë forcën e vendimeve të gjykatave si një marrëdhnie me përcaktime të qarta ligjore dhe nuk mund të vërë në dyshim mospagesën ndaj kreditorit. Veprimet duhet të kryeheshin me inisiativë të vetë institucionit dhe jo nëpërmjet Zyrave të Përbarimit të cilat i paraqesin me qëllim përfitimi nga ana e tyre.Praktikisht veprimet nuk kanë patur asnjë ndikim nga Zyrat e përbarimit se likuidimit janë kryer vetëm kur buxheti i shtetit ka gjetur burimet të cilat përcaktohen sipas një kuote në raport me të ardhurat e buxhetit përcaktuar në ligjin e buxhetit të cdo viti (Trajtuar në faqet 192-228 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet,duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përbarimore me qëllim kërkimin e kthimit të shumës prej 1,227,223 lekë (sipas listes në tëbelën aneks 1) të paguar zyrave përbarimore padrejtësisht dhe me pabazueshmëri të plotë ligjore.

Brenda muajit Mars 2019

3.Gjetje: Sipas urdhër shpenzimeve nr.295, datë 30.12.2015, nr.208, datë 31.10.2016 dhe urdhër shpenzimit nr.258, datë 28.12.2016 është likuiduar vlera totale prej 22,114,576 lekë dhe zëri i shpenzimit është vendosur “Data entry, hedhje vendimesh” ndërkohë që sipas kontratës dhe termave të references, bëhet fjalë për hedhje në sistem të dosjeve në total dhe jo vetëm vendimeve të tyre. Duke qenë se pagesat janë bërë për 69533 dosje, ndërkohë që në arkivën e ATP kanë qenë 43942 dosje në total në kohën e zhvillimit të prokurimit publik për sistemin Web-Gis, diferenca prej [(25591 dosje X 265 lekë/dosje (çmimi për njësi pa TVSH)) + 20% TVSH] = 8,137,938 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik i shkaktuar buxhetit të shtetit nga pagesat e kryera për shërbime të pakryera ndaj Autoritetit Kontraktor.

Ndër të tjera nga verifikimi në sistemin Web-Gis i dosjeve të hedhura, rezulton se 5799 prej tyre janë të pozicionuara gabim gjeografikisht, që do të thotë se ky shërbim nuk është kryer në përputhje me kushtet e kontratës edhe operatori nuk duhet të likuidohej pa përfunduar shërbimin sipas kushteve të kontratës. Për pasojë vlera prej 1,844,082 lekë [(5799 X 265 lekë/dosje) + 20%] përbën dëm ekonomik (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim:Agjencia e Trajtimit të Pronave, Tiranë, të marrë masa për:

a. kërkimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe shkallët e gjyqimit për shpërblimin e dëmit në vlerën prej 9,982,020 lekë nga bashkimi i operatorëve ekonomik “C. P. & G. C.”, si pagesa për shërbime të pakryera ndaj Autoritetit Kontraktor.

b. të dërguar me shkresë zyrtare Agjencisë së Prokurimit Publik informacionin për mosrealizim kontrate dhe për përjashtim nga prokurimi publik me afat të 3 vjeçar.

Brenda muajit Mars 2019

4.Gjetje: Në 2 raste u konstatua se ATP ka marrë vendime për kompensim financiar në vlerën 94,762,840 lekë dhe kompensim fizik me sipërfaqen 45227.5 m² arë, thjesht mbi bazën e një shkrese pa vulë, që i referohet vendimit të pretenduar të ish-KKKP. Këto shkresa nuk kanë emërtimin Vendim, nuk kanë nr. dhe as datën e vendimit të pretenduar, nuk dihet se cilët kanë qenë anëtarët e KKKP të cilët kanë marrë vendimin, si dhe mungon pjesa arsyetuese. Pra, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me vendim të KKKP sepse shkresat nuk ka elementët e formës dhe përmbajtjes së vendimit, e mbi të gjitha i mungon vula, si mjet identifikues dhe ligjërues i vendimeve të marra nga ish-KKKP dhe pjesa arsyetuese. Për pasojë, vendimet për kompensim financiar të bërë nga ATP, në mungesë të vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, pra dokumentit ligjor mbi të cilin ATP mundet të jap vendim për kompensimin financiar, vlera prej 94,762,840 lekë do të konsiderohet si efekt financiar negativ në fondin e kompensimit të ish-pronarëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (Më hollësisht trajtuar në faqet 86-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe shkallët e gjyqimit për kthimin e vlerës 94,762,840 lekë në fondin e kompensimit të ish-pronarëve dhe kthimin e kompensimit fizik të sipërfaqes 45227.5m² arë, të cilat janë kompensuar në kundërshtim me ligjin dhe konkretisht në mungesë të vendimeve të ish-KKKP.

Brenda muajit Mars 2019

C.MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje: Në 1 rast, sipas urdhër-shpenzimit nr. 268, datë 29.12.2017, janë kryer shpenzime në shumën 838,800 lekë, me objekt “Shpenz. Mirëmb.Makinave TR 3225 L; TR 0988 L; TR 8016 U”, në kredi të përfituesit: **K.” shpk**, nga sektori i Burimeve Njerëzore në kushtet e një akt-konstatimi formal të mbajtur nga Komisioni, por në këtë Akt-Konstatimi nuk janë argumentuar nga grupi i punës të dhënat mbi gjëndjen fillestare të automjeteve, amortizimin, të dhënat për kilometrat e përshkruara nga automjetet, shërbimet e kryera, investimet kapitale dhe të përcaktohej nevoja për shërbime mirëmbajtje, mbështetur në dokumentacionin argumentues për kërkesën e bërë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, pika 36 .

Sipas proces-verbalit të marrjes në dorëzim, nuk rezulton të jenë kryer verifikime, duke përshkruar procedurën e kryer, përshkrimin e veprimeve të kryera, krahasimet e faktit me dokumentacionin e ofertës fituese, si certifikata origjinale dhe cilësie, kryerjen e provave me zgjedhje, garanci malli, etj

Shuma e mësipërme prej 838,800 lekë është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Këto veprime janë në kundërshtim me 42-50, të udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 92- 155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: ATP Tiranë të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **prej 838,800 lekë, prej përfituesit të paligjshëm ”K.” shpk**, e cila përfaqëson “Shpenz. Mirëmb.Makinave TR 3225 L; TR 0988 L; TR 8016 U” të pa dokumentuar e vërtetuar sipas procedurave ligjore, në të kundërt shuma të likuidohet nga personat përgjegjës.

Brenda muajit Mars 2019

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996, ligjin nr.9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr.136/2015 dhe në ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas shkallës së përgjegjësisë individuale më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore “Mosngritje në detyrë” dhe “Vërejtje” deri “Largim nga puna”, për këta punonjës:

Për punonjësit aktualë:

d.1 Masë disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Puna”

1. A. M., Drejtor i Kompensimit
2. A. Z., Përgjegjëse sektori
3. G. S., specialist
4. M. B., specialist
5. A. H., specialiste
6. A. L., specialiste

d.2 Masa disiplinore “Mos ngritje në detyrë”

1. V. T., Përgjegjës sektori

d.3 Masa disiplinore “Vërejtje” për:

1. J. M., specialist jurist
2. J. Ç., specialist
3. B. M., specialist
4. A. K., specialiste
5. E. B., specialist
6. E. M., specialist
7. D. B., specialist
8. A. M., specialiste
9. E. Sh., specialist
10. R. K., specialiste
11. Z. S., specialiste
12. A. L., specialist
13. M. P., specialiste
14. J. Ç., specialiste

Për fakën se:

-Në **22 raste**, sipas vendimeve të ATP-së për kompensim financiar/fizik, konstatohet se në dosje mungonte dokumentacioni për të vërtetuar kryerjen e shpronësimit, kohën si dhe zërin kadastral në kohën e shpronësimit, por është përdorur harta përkatëse më e afërt me këtë kohë. Në këto kushte, duhej të bëheshin veprime për të marrë për bazë çmimi minimal sipas hartës së vlerës së pronës për atë njësi administrative dhe kategori prone.

Përsa i takon problematikës së mësipërme, në kuptim të pikës 3, germa ” d” të VKM nr.Nr. 223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e

fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, ka munguar metodologjia nga Agjencia e Trajtimit të Pronave lidhur me interpretimin e pikës 3, dhe as i është përcjellë ndonjë material Ministrisë së Drejtësisë për këtë qëllim. Trajtimi i këtyre problemeve nga ATP është në kundërshtim me pikën 3, germa “d”, të VKM nr. 223, datë 23.3.2016.

-Në **9 raste**, për shumën **284,546,878 lekë**, sipas vendimeve të ATP-së për kompensim financiar/fizik me numër: nr.253, datë 01.12.2016; nr.488, datë 28.03.2017; 460, dt.28.03.2017; 179,dt.01.12.2016; 529,dt.25.04.2017; 257,dt.01.12.2016; 496 dt.28.03.2017; 45 dt.17.02.2017; 55 dt.17.02.2017, konstatohet se në dosje mungonte dokumentacioni për të vërtetuar kryerjen e shpronësimit, kohën si dhe zërin kadastral në kohën e shpronësimit dhe nga verifikimi i hartës dixhitale të pamiratuara, konstatohet se pronat në fjalë janë jashtë vijave kufizuese (vija e verdhë). Vlera prej 284,546,878 lekë, përfaqëson diferencën ndërmjet vlerës së llogaritur për kompensim financiar e fizik të sipërfaqes “Truall” dhe vlerës që duhej llogaritur sipas çmimit minimal të tokës dhe tokës “Arë”, rrjedhimisht nuk është zbatuar procedura e plotë e rillogaritjes dhe mosargumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar, në moszbatim të pikës 3, germa “d” të VKM nr. 223, datë 23.3.2016.

-Në të gjithë rastet (**52 raste**), në dosjet e audituara sipas vendimeve për kompensim financiar/fizik, ka kryer kompensimet financiare në mungesë të dokumentacionit vërtetues të faktit të mospërfitimit nga vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, kompensime të cilat duhej të zbriteshin nga shuma e përlllogaritur për kompensim. Për këtë ka përdorur VKM e cila ka lejuar bërjen e nje deklarate noteriale nga aplikuesit qe nuk kanë përfituar nga sa trajtuar më sipër, por kjo sigurisht nuk jep garanci absolute dhe duhet që të kërkohet ndryshimi i nenit 36 të ligjit 133/2015, duke u shprehur qartësisht, pasi në shkallën juridike ligji prevalon mbi VKM, ndaj duhet të bëhet plotësimi ligjor.

-Në **1 rast**, vlerësimi i pronës për kthim është më i lartë se vlerësimi i pronës së lënë për kompensim, dhe subjekti konsiderohet i kompensuar dhe vlera e lënë për kompensim prej **25,201,890 lekë**, në kushtet kur zëri kadastral në kohën e shpronësimit ka qenë tokë “Arë” (Pemishte) dhe është vlerësuar “Truall”, rrjedhimisht *nuk është zbatuar procedura e plotë e rillogaritjes dhe nuk është kryer argumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar.*

-Në Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), për zbatimin e 56 rekomandimeve rezultojnë se 2 rekomandime të lëna në auditimin e mëparshëm, nuk janë pranuar për shkak të ndryshimeve ligjore dhe nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës **125,854,404 lekë**, duke mos ndjekur procedurat ligjore të bashkëpunimit, argumentimit ligjor dhe ndjekjes ligjore në kundërshtim me nenin 15 (pika k), nenin 29 “pika 2” dhe nenin 30 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” (Më hollësisht trajtuar në faqet 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Në ATP janë **145 dosje** për të cilat janë dërguar shkresat për “Plotësim dokumentacioni” subjekteve përkatëse, dhe të cilave u kanë kaluar afatet ligjore të paraqitjes së dokumentacionit plotësues tekniko-ligjor nga subjektet. Për këto dosje specialistët nuk kanë përfunduar procedurat ligjore për paraqitjen e informacionit përgatës argumentues deri në vendimmarrje, në mënyrë që procesi i trajtimit të pronave për këto subjekte të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në ligj. Për faktin se:

-Në **22 raste**, sipas vendimeve të ATP-së për kompensim financiar/fizik, konstatohet se në dosje mungonte dokumentacioni për të vërtetuar kryerjen e shpronësimit, kohën si dhe zërin kadastral në kohën e shpronësimit, por është përdorur harta përkatëse më e afërt me këtë kohë. Në këto kushte, duhej të bëheshin veprime për të marrë për bazë çmimi minimal sipas hartës së vlerës së pronës për atë njësi administrative dhe kategori prone.

Përsa i takon problematikës së mësipërme, në kuptim të pikës 3, germa ” d” të VKM nr.Nr. 223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, ka munguar metodologjia nga Agjencia e Trajtimit të Pronave lidhur me interpretimin e pikës 3, dhe as i është përcjellë ndonjë material Ministrisë së Drejtësisë për këtë qëllim. Trajtimi i këtyre problemeve nga ATP është në kundërshtim me pikën 3, germa “d”, të VKM nr. 223, datë 23.3.2016.

-Në **9 raste**, për shumën **284,546,878 lekë**, sipas vendimeve të ATP-së për kompensim financiar/fizik me numër: nr.253, datë 01.12.2016; nr.488, datë 28.03.2017; 460, dt.28.03.2017; 179,dt.01.12.2016; 529,dt.25.04.2017; 257,dt.01.12.2016; 496 dt.28.03.2017; 45 dt.17.02.2017; 55 dt.17.02.2017, konstatohet se në dosje mungonte dokumentacioni për të vërtetuar kryerjen e

shpronësimi, kohën si dhe zërin kadastral në kohën e shpronësimi dhe nga verifikimi i hartës dixhitale të pamiratuara, konstatohet se pronat në fjalë janë jashtë vijave kufizuese (vija e verdhë). Vlera prej 284,546,878 lekë, përfaqëson diferencën ndërmjet vlerës së llogaritur për kompensim financiar e fizik të sipërfaqes “Truall” dhe vlerës që duhej llogaritur sipas çmimit minimal të tokës dhe tokës “Arë”, rrjedhimisht nuk është zbatuar procedura e plotë e rillogaritjes dhe mosargumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar, në moszbatim të pikës 3, germa “d” të VKM nr. 223, datë 23.3.2016.

-Në të gjithë rastet (**52 raste**), në dosjet e audituara sipas vendimeve për kompensim financiar/fizik, ka kryer kompensimet financiare në mungesë të dokumentacionit vërtetues të faktit të mospërfitimit nga vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, kompensime të cilat duhej të zbriteshin nga shuma e përlllogaritur për kompensim. Për këtë ka përdorur VKM e cila ka lejuar bërjen e një deklarate noteriale nga aplikuesit që nuk kanë përfituar nga sa trajtuar më sipër, por kjo sigurisht nuk jep garanci absolute dhe duhet që të kërkohet ndryshimi i nenit 36 të ligjit 133/2015, duke u shprehur qartësisht, pasi në shkallën juridike ligji prevalon mbi VKM, ndaj duhet të bëhet plotësimi ligjor.

-Në **1 rast**, vlerësimi i pronës për kthim është më i lartë se vlerësimi i pronës së lënë për kompensim, dhe subjekti konsiderohet i kompensuar dhe vlera e lënë për kompensim prej 25,201,890 lekë, në kushtet kur zëri kadastral në kohën e shpronësimi ka qenë tokë “Arë” (Pemishte) dhe është vlerësuar “Truall”, rrjedhimisht *nuk është zbatuar procedura e plotë e rillogaritjes dhe nuk është kryer argumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar.*

-Në **9 raste** u konstatua se ATP ka bërë përlllogaritje të gabuar të kompensimit të subjekteve të shpronësuara në vlerën totale prej 314,043,899 lekë mbi bazën e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të bëra për zërin kadastral “Truall”, dhe jo sipas zërit kadastral që prona ka patur në kohën e shpronësimi. **ATP nuk ka vlerësuar financiarisht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka patur prona në kohën e shpronësimi, duke shmangur procedurën e rregullt ligjore për identifikimin e llojit të pasurisë në kohën e shpronësimi (mund të ketë qenë tokë bujqësore, pyll, kullotë etj.).** Vendimet për kompensim janë marrë në mungesë të dokumentit të shpronësimi për sipërfaqet e kompensuara mbi bazën e të cilit do të përcaktohej koha e shpronësimi, si dhe zëri kadastral i pronës në kohën e shpronësimi. Edhe në rastet kur ATP në pamundësi për të verifikuar kohën e saktë të shpronësimi, pa të drejtë, i është referuar hartës së viteve 1937-1938, nga verifikimi i së cilës, realisht, ka qenë i pamundur përcaktimi i zërit kadastral. **Si rezultat i përcaktimit të gabuar të zërit kadastral dhe moszbatimit të procedurës së rregullt ligjore të vlerësimit financiar rezulton diferenca e paargumentuar prej 314,043,899 lekë.** Këto veprime janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” dhe pikën 3, germa a dhe d të VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” ku citohet “ATP-ja, për efekt të kompensimit dhe të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, vlerëson financiarisht vendimet, duke u bazuar në vlerat e përcaktuara në hartën e vlerës, si më poshtë vijon: a) Vlerëson financiarisht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimi, duke u bazuar në hartën e vlerës; d) Zëri kadastral i origjinës së pronës përcaktohet duke u bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje ose, në mungesë të këtij të fundit, për përcaktimin e zërit kadastral do të përdoret harta e kohës së shpronësimi dhe, në mungesë të saj, harta që është më e afërt me kohën e shpronësimi; në pamundësi objektive për përcaktimin e zërit kadastral, sipas kësaj shkronje, atëherë vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht me çmimin minimal, të përcaktuar në hartën e vlerës për atë njësi administrative dhe për atë kategori prone;”

Në **1 prej këtyre rasteve** u konstatua se, si pasojë e moszbatimit të procedurës së rregullt ligjore të vlerësimit financiar të vendimeve për kompensim, **subjektet e shpronësuara janë kompensuar fizikisht më tepër me sipërfaqen totale prej 71,408m² (7.14 ha) arë.** Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, i ndryshuar dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar.

-Në **2 raste** u konstatua se ATP ka marrë vendime për kompensim financiar në vlerën **94,762,840 lekë dhe kompensim fizik me sipërfaqen 45227.5m² arë, thjesht mbi bazën e një shkrese pa vullë, që i referohet vendimit të pretenduar.** Këto shkresa nuk kanë emërtimin

Vendim, nuk kanë nr. dhe as datën e vendimit të pretenduar, nuk dihet se cilët kanë qenë anëtarët e KKKP të cilët kanë marrë vendimin, si dhe mungon pjesa arsyetuese. Pra, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me vendim të KKKP sepse *shkresa nuk ka elementët e formës dhe përmbajtjes së vendimit, e mbi të gjitha i mungon vula si mjet identifikues dhe ligjërues i vendimeve të marra nga ish-KKKP dhe pjesa arsyetuese*. Për pasojë, vendimet për kompensim financiar të bërë nga ATP, në mungesë të vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, pra dokumentit ligjor mbi të cilin ATP mundet të jap vendim për kompensimin financiar, do të konsiderohen si absolutisht i pavlefshëm dhe **vlera prej 94,762,840 lekë do të konsiderohet si efekt financiar negativ në fondin e kompensimit të ish-pronarëve**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”.

-Në 5 raste, ATP ka bërë rivlerësim të vendimeve administrative të formës së prerë të cilët kanë vendosur kompensimin financiar duke rritur vlerën e kompensimit me 7,428,000 lekë për shkak të çmimit më të lartë të truallit për m² në disa Zona Kadastrale. Ky veprim bie në kundërshtim të Vendimit nr.1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese ku citohet “Gjykata Kushtetuese, lidhur me dispozitat që parashikojnë që vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi, vlerëson se ato ngrenë çështjen e “pritshmërisë legjitime”, por sipas ligjit nuk do t’i nënshtrohen rivlerësimit.” dhe qëndrimin të Komisionit të Venecias nr.861/2016, CDL-AD (2016) 023, i cili shprehet “Vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi... nuk do t’i nënshtrohen rivlerësimit sipas ligjit nr.133/2015.”

-Në 13 raste, ATP nuk ka kërkuar informacion nga ZVRPP, nga Këshilli i Qarkut (DAMT), apo organet e tjera përkatëse të pushtetit vendor nëse trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar kanë të regjistruar apo ka përfituar tokë bujqësore sipas Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”. Gjithashtu nuk është kërkuar informacion dhe nuk ka ndonjë vërtetim nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore përkatëse nëse në lidhje me çështjen ka apo jo ndonjë vendim të formës së prerë apo është në proces gjyqësor për pronën e përfituar me vendim të ish-KKKP. Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, i ndryshuar.

-Në 7 raste, ATP nuk ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, pranë Ministrisë së Financave, për objektet të cilave u është njohur e drejta e parablerjes, nëse janë privatizuar apo jo. Veprim në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, i ndryshuar.

-Në 1 rast, në lidhje me vazhdimin e zbatimit të kontratës së prokurimit publik, **“Sistemi Web-Gis informacioni për regjistrimin dhe vlerësimin e pronave objekt kthimi dhe kompensimi AKPP-Web-Gis” viti 2015**, sipas urdhër shpenzimeve nr.295, datë 30.12.2015, nr.208, datë 31.10.2016 dhe nr.258, datë 28.12.2016, është likujduar vlera totale prej 22,114,576 lekë. Zëri i shpenzimit është vendosur “Data entry, hedhje vendimesh” ndërkohë që sipas kontratës dhe termave të referencës bëhet fjalë për hedhje në sistem të dosjeve në total dhe jo vetëm vendimeve që ato përmbajnë. Duke qenë se pagesat janë bërë për 69533 dosje, ndërkohë që në arkivën e ATP kanë qenë 43942 dosje në total në kohën e zhvillimit të prokurimit publik për sistemin Web-Gis, **diferenca prej [(25591 dosje X 265 lekë/dosje (çmimi për njësi pa TVSH)) + 20% TVSH] = 8,137,938 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik i shkaktuar buxhetit të shtetit nga pagesat e kryera për shërbime të pakryera ndaj Autoritetit Kontraktor.**

Ndër të tjera nga verifikimi në sistemin Web-Gis i dosjeve të hedhura, rezulton se 5799 prej tyre janë të pozicionuara gabim gjeografikisht, që do të thotë se ky shërbim nuk është kryer në përputhje me kushtet e kontratës edhe operatori nuk duhet të likujdohej pa përfunduar shërbimin sipas kushteve të kontratës. Për pasojë **vlera prej 1,844,082 lekë [(5799 X 265 lekë/dosje) + 20%] përbën dëm ekonomik.**

Pra, dëmi ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit si pasojë e pagesave të kryera për shërbime të pakryera arrin në vlerën totale prej 9,982,020 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, i kryer nga grupi i auditimit, në lidhje me ankesën e shtetasit Sh. T., u konstatua se Vendimi nr.484, datë 03.12.2015 për tjetërsimin e

oborrit në përdorim, me sipërfaqe 500m², në favor të B. P., është dhënë në kundërshtim me pikat 5 dhe 8 të VKM nr.578, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, i ndryshuar, si dhe nenin 25/c të Ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar për arsyet si mëposhtë:

1. objekti është ngritur mbas datës 10.08.1991,

2. nuk mund të vërtetohet se pronat nuk janë transferuar në inventarin e pronave të organeve të qeverisjes vendore, në përputhje me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, për shkak se nuk ka përfunduar procesi i inventarizimit,

3. sipërfaqja e tokës nuk rezulton fizikisht e lirë sepse në sipërfaqen prej 500 m² truall e miratuar si oborr në përdorim në favor të B. P. rezultojnë të ndodhen edhe 2 (dy) objekte të tjera (pa leje).

4. regjistrimi në ZVRPP Tiranë i Vendimit të Gjykatës nr.2492, datë 13.07.1993 “Për vërtetimin e faktit juridik”, mbi bazën e të cilit është marrë Vendimi nr.484, datë 03.12.2015 për tjetërsimin e oborrit në përdorim, me sipërfaqe 500 m², në favor të B. P., është bërë në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në kundërshtim me nenin 45/2 të Ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

-Në ATP, janë rreth **656 dosje** te cilat kanë kaluar nga arkiva në protokoll dhe me urdhër u janë shpërndarë specialistëve përkatës. Për këto dosje nuk kanë përfunduar procedurat ligjore për të marrë një vendim, por procesi është zgjatur e zvarritur me 3-4 vite. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar, si dhe pikës 6 të VKM nr. 222, datë 23.3.2016 “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj” dhe urdhërin nr.277, datë 10.10.2016 neni 6,8,16.

-Në regjistrat e mbajtur gjatë vitit 2016, 2017 dhe viti 2018 mbi kërkesat, ankesat, informacionet për dosjet kostatohet se këto regjistra janë të pa vulosur, nuk përmbajnë sasinë e fletëve, nuk përshkruhet se nga cili specialist është mbajtur, nuk kanë të mbushura kolonat përkatëse me të gjithë modalitetet e duhur, formati ka qenë në forma të ndryshme sipas dëshirës së specialistëve të protokollit, janë mbajtur me qindra nr. protokollit bosh dhe vazhdohet në numra rendore të tjerë dhe konkretisht regjistri i mbajtur në periudhën Qeshor - Tetor 2016, fillon me nr. rendor 6553 dhe vazhdon me nr. 6622 pra janë 69 nr. protokollit bosh, regjistruar një person në nr. 6662 dhe vazhdon në nr. 6689 dhe 6691 dhe përsëri ka numra bosh deri 6795. Pra, në total janë 104 vende bosh ku regjistrohen persona edhe po të kenë ardhur më vonë, rendi kronologjik nuk mbahet sipas rradhës e rendit numerik janë rreth 30 fletë të pambushura dhe janë mbajtur nr.protokollit bosh. Këto veprime janë në kundërshtim me Regulloren e ATP me nr.277, datë 10.10.2016 neni 6, pika 2 dhe neni 28 “Sektori i Protokollit”

-Dosja me nr.275, datë 28.03.2017 sipas Vendimit nr.493, datë 28.03.2017, të marrë nga ATP kostatohet se janë marrë informacionet nga ZVRPP Shkodër me nr.2651, datë 11.07.2016 ku figuron pronë “Shtet”, vertetim nga Gjykata e Rrethit Shkodër që nuk ka proces gjyqësor.

Pra sipas dokumentacionit të pasur në dosje rezulton se mugojnë informacionet nga Agjencia e Legalizimit të pronave, nuk ka dokument nga Arkiva e shtetit apo nga kadastra e tokave.

Pra dosja është e pa plotësuar me dokumentat përkatëse sipas nenit 36 ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” si dhe VKM nr.221, datë 23.03.2016 pika 3 dhe pika 13, për shpronsimin e pronës së qytetarit A. M., Shkodër, për sipërfaqen 616m² në vlerën 5,238,521 lek

D.2.2 Masë disiplinore “Vërejtje” për:

22. E. I., Përgj. e Sektorit të Financës

Për faktin se:

-Në **45 raste**, sipas urdhër shpenzimeve janë kryer shpenzim në shumën totale 76,302,843 lekë, me objekt “Paga bazë, shtesë page, raporte mjekësore+honorare”, në kredi të punonjësve të ATP-së, sipas listë-pagesave bashkëlidhur urdhër-shpenzimeve të vitit 2017, në mungesë të listë-prezencave bashkëlidhur të nëshkruar nga personat kompetentë, sektori burimeve njerëzore i caktuar sipas ligjit dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, pika 69.

-Në **25 raste**, për vitin 2017, sipas urdhër shpenzimeve përkatëse u konstatua se janë kryer shpenzime në shumën **2,464,000 lekë**, në kredi të **12 punonjësve të ATP**, për udhëtime dhe dieta

brenda vendit, shpenzime bazuar në urdhra të paligjshëm, për bashkëpunimin me institucionet e treta si ZVRPP Malësi e Madhe, ZVRPP Shkodër, Bashki Malësi e Madhe (Njësitë Administrative përkatëse), Bashkia Shkodër, Prerrefektura Shkodër, Këshilli i Qarkut Shkodër, ZVRPP Vorë, ZVRPP Sarandë, Bashki Vlorë, Bashkia Sarandë, Bashkia Himarë (Njësitë Administrative përkatëse), Prerrefektura Vlorë, Këshilli i Qarkut Vlorë, për të verifikuar Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi që i përkasin këtij Qarku, referuar pretendimeve për njohje pronësie të trashëgimtarëve të subjekteve të shpronësuar të cilët kanë pretendimet e tyre pranë ATP, ose me qëllime marrje përgjigje nga këto institucione.

Këta urdhra janë në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, neni 36.

Shuma e mësipërme prej 2,464,000 lekë është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Brenda kësaj shume nga auditimi me zgjedhje, u konstatua se me urdhër shpenzimet nr.27/1,28,29 datë 14.02.2017; nr.38, 39, 40, datë 21.02.2017, janë kryer shpenzime në shumën totale 847,000 lekë, me objekt “Shpenzim Udhëtim i brendshëm-Dieta”, në kredi të përfituesit: Punonjësit e ATP Tiranë, sipas borderosë së dietave, janë paguar punonjës, me dokumentacione të parregullt, urdhërs shërbime të pafirmosura nga pesronat udhëtues dhe urdhërues, fatura hoteli me 10 punonjës për çdo faturë tatimore të pafirmosura nga personat udhëtues, etj, në kundërshtim me VKM nr.329, datë 20.04.2016 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

-Në 10 raste, nga auditimi me zgjedhje për vitin 2017, sipas urdhër shpenzimeve përkatëse janë kryer shpenzime në shumën totale 16,161,729 lekë, me objekt “Blerje pajisje, kryerje shërbime, riparime etj.”, në kredi të operatorëve ekonomikë, marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve, në mungesë të specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit, mbi bazën e të cilave komisioni duhej të kryente verifikimin fizik të aktiveve në sasi, cilësi dhe çmim. Këto dokumente nuk ndodhen në dosje, kështu që komisioni realisht nuk ka kryer verifikim, duke patur parasysh edhe kontratat e lidhura.

Sipas proces-verbaleve të marrjes në dorëzim, nuk rezulton të jenë kryer verifikime, duke përshkruar procedurën e kryer, përshkrimin e veprimeve të kryera, krahasimet e faktit me dokumentacionin e ofertës fituese, si certifikata origjinale dhe cilësie, kryerjen e provave me zgjedhje, fleta analize laboratorike, garanci malli, etj.

Sa sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, pikat 42-50 (47).

- Në 1 rast, sipas urdhër-shpenzimit nr. 268, datë 29.12.2017, janë kryer shpenzime në shumën 838,800 lekë, me objekt “Shpenz. mirëmb.makinave TR 3225 L; TR 0988 L; TR 8016 U”, nga Sektori i Burimeve Njerëzore në kushtet e një akt-konstatimi formal të mbajtur nga Komisioni, por në këtë Akt-Konstatimi nuk janë argumentuar nga grupi i punës të dhënat mbi gjëndjen fillestare të automjeteve, amortizimin, të dhënat për kilometrat e përshkruara nga automjetet, shërbimet e kryera, investimet kapitale dhe të përcaktohej nevoja për shërbime mirëmbajtje, mbështetur në dokumentacionin argumentues për kërkesën e bërë.

Sipas proces-verbalit të marrjes në dorëzim, nuk rezulton të jenë kryer verifikime, duke përshkruar procedurën e kryer, përshkrimin e veprimeve të kryera, krahasimet e faktit me dokumentacionin e ofertës fituese, si certifikata origjinale dhe cilësie, kryerjen e provave me zgjedhje, fleta analize laboratorike, garanci malli, etj

Shuma e mësipërme prej 838,800 lekë është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Këto veprime janë në kundërshtim me 42-50, të udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Në 1 rast, nga auditimi me zgjedhje për vitin 2017, sipas urdhër shpenzimit nr. 80, datë 13.04.2017, janë kryer shpenzime në shumën 600,000 lekë, me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrove PROJ.GIS”, në kredi të operatorit ekonomik ”COMMUNICATION PROGRESS”, kushtet kur fatura tatimore është një përmbledhje dhe nuk përmban zërat e shpenzimeve sipas listës së specifikimit dhe nuk përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës dhe të tjera të dhëna të nevojshme që t'i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative

Shuma e mësipërme prej 600,000 lekë është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Sa sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, pika 36.

-Në **1 rast**, në lidhje me vazhdimin e zbatimit të kontratës së prokurimit publik, **“Sistemi Web-Gis informacioni për regjistrimin dhe vlerësimin e pronave objekt kthimi dhe kompensimi AKPP-Web-Gis” viti 2015**, sipas urdhër shpenzimeve nr.295, datë 30.12.2015, nr.208, datë 31.10.2016 dhe nr.258, datë 28.12.2016, është likujduar vlera totale prej 22,114,576 lekë. Zëri i shpenzimit është vendosur “Data entry, hedhje vendimesh” ndërkohë që sipas kontratës dhe termave të referencës bëhet fjalë për hedhje në sistem të dosjeve në total dhe jo vetëm vendimeve që ato përmbajnë. Duke qenë se pagesat janë bërë për 69533 dosje, ndërkohë që në arkivën e ATP kanë qenë 43942 dosje në total në kohën e zhvillimit të prokurimit publik për sistemin Web-Gis, **diferenca prej [(25591 dosje X 265 lekë/dosje (çmimi për njësi pa TVSH)) + 20% TVSH] = 8,137,938 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik i shkaktuar buxhetit të shtetit nga pagesat e kryera për shërbime të pakryera ndaj Autoritetit Kontraktor.**

Ndër të tjera nga verifikimi në sistemin Web-Gis i dosjeve të hedhura, rezulton se 5799 prej tyre janë të pozicionuara gabim gjeografikisht, që do të thotë se ky shërbim nuk është kryer në përputhje me kushtet e kontratës edhe operatori nuk duhet të likujdohej pa përfunduar shërbimin sipas kushteve të kontratës. Për pasojë **vlera prej 1,844,082 lekë [(5799 X 265 lekë/dosje) + 20%] përbën dëm ekonomik.**

Pra, dëmi ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit si pasojë e pagesave të kryera për shërbime të pakryera arrin në vlerën totale prej 9,982,020 lekë.

II. Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.

Për 7 ish-punonjës, edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte nga **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”** deri në **“Largim nga puna (zgjidhje e kontratës)”**, përkatësisht për: **O. Rr., ish-drejtor kompensimi D. N., E. M., B. G., A. H., A. L., J. Ç. dhe G. P.**

D.KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 281, të Ligjit nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr.33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, për shkeljet e konstatuara dhe pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Adutimit, në kuptim të referencave të Kodit Penal, **të dërgohet për indicie i gjithë materiali i përgatitur, duke evidentuar përgjegjësinë individuale dhe nivelin e shkeljeve ligjore**, që ju përkasin personave si më poshtë:

1.O. Rr. ish-Drejtor i Kompensimit dhe nëndrejtor i Përgjithshëm,

Për shkeljet e mëposhtme, pasi:

-Nuk ka kërkuar informacion nga ZVRPP, nga Këshilli i Qarkut (DAMT), apo organet e tjera përkatëse të pushtetit vendor nëse trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar kanë të regjistruar apo ka përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”. Gjithashtu nuk është kërkuar informacion dhe nuk ka ndonjë vërtetim nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore përkatëse nëse në lidhje me çështjen ka apo jo ndonjë vendim të formës së prerë apo është në proces gjyqësor për pronën e përfituar me vendim të ish-KKKP. Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 36 të ligjit nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar.

-Nuk ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, pranë Ministrisë së Financave, për objektet të cilave u është njohur e drejta e parablerjes, nëse janë privatizuar apo jo. Veprim në kundërshtim me nenin 36 të ligjit nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar.

-Në 2 raste u konstatua se janë marrë vendime për kompensim financiar në vlerën **94,762,840 lekë dhe kompensim fizik me sipërfaqen 45227.5m² arë**, mbi bazën e një shkrese pa vulë, që i referohet

vendimit të pretenduar. Këto shkresa nuk kanë emërtimin Vendim, nuk kanë nr. dhe as datën e vendimit të pretenduar, nuk dihet se cilët kanë qenë anëtarët e KKKP të cilët kanë marrë vendimin, si dhe mungon pjesa arsytuese. Pra, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me vendim të KKKP sepse *shkresa nuk ka elementët e formës dhe përmbajtjes së vendimit, e mbi të gjitha i mungon vula si mjet identifikues dhe ligjërues i vendimeve të marra nga ish-KKKP dhe pjesa arsytuese*. Për pasojë, vendimet për kompensim financiar të bërë nga ATP, në mungesë të vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, pra dokumentit ligjor mbi të cilin ATP mundet të jap vendim për kompensimin financiar dhe vlera prej 94,762,840 lekë do të konsiderohet si efekt financiar negativ në fondin e kompensimit të ish-pronarëve. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”.

-Në 10 raste u konstatua se ATP ka bërë përlllogaritje të kompensimit të subjekteve të shpronësuara në vlerën totale prej 350,189,095 lekë mbi bazën e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të bëra për zërin kadastral “Truall”, dhe jo sipas zërit kadastral që prona ka patur në kohën e shpronësimit. ATP nuk ka vlerësuar financiarisht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka patur prona në kohën e shpronësimit, duke shmangur procedurën e rregullt ligjore për identifikimin e llojit të pasurisë në kohën e shpronësimit (mund të ketë qenë tokë bujqësore, pyll, kullotë etj.). Vendimet për kompensim janë marrë në mungesë të dokumentit të shpronësimit për sipërfaqet e kompensuara mbi bazën e të cilit do të përcaktohej koha e shpronësimit, si dhe zëri kadastral i pronës në kohën e shpronësimit. Edhe në rastet kur ATP në pamundësi për të verifikuar kohën e saktë të shpronësimit, pa të drejtë, i është referuar hartës së viteve 1937-1938, nga verifikimi i së cilës, realisht, ka qenë i pamundur përcaktimi i zërit kadastral. Këto veprime janë kryer në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe pikën 3, gërma a dhe d të VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” ku citohet “ATP-ja, për efekt të kompensimit dhe të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, vlerëson financiarisht vendimet, duke u bazuar në vlerat e përcaktuara në hartën e vlerës, si më poshtë vijon: a) Vlerëson financiarisht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimit, duke u bazuar në hartën e vlerës; d) Zëri kadastral i origjinës së pronës përcaktohet duke u bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje ose, në mungesë të këtij të fundit, për përcaktimin e zërit kadastral do të përdoret harta e kohës së shpronësimit dhe, në mungesë të saj, harta që është më e afërt me kohën e shpronësimit; në pamundësi objektive për përcaktimin e zërit kadastral, sipas kësaj shkronje, atëherë vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht me çmimin minimal, të përcaktuar në hartën e vlerës për atë njësi administrative dhe për atë kategori prone;”

Në 2 prej këtyre rasteve u konstatua se, si pasojë e moszbatimit të procedurës së rregullt ligjore të vlerësimit financiar të vendimeve për kompensim, subjektet e shpronësuara janë kompensuar fizikisht më tepër me sipërfaqen totale prej 145735.6m² (14.57 ha) arë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr.133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar dhe VKM Nr.223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar.

-Në 9 raste, për shumën 283,626,509 lekë, sipas vendimeve të ATP-së për kompensim financiar/fizik, konstatohet se në dosje mungonte dokumentacioni për të vërtetuar kryerjen e shpronësimit, kohën si dhe zërin kadastral në kohën e shpronësimit dhe nga verifikimi i hartës dixhitale të pamiratuara, konstatohet se pronat në fjalë janë jashtë vijave kufizuese (vija e verdhë). Vlera prej 283,626,509 lekë, përfaqëson diferencën ndërmjet vlerës së llogaritur për kompensim financiar e fizik të sipërfaqes “Truall” dhe vlerës që duhej llogaritur sipas çmimit minimal të tokës dhe tokës “Arë”, rrjedhimisht nuk është zbatuar procedura e plotë e rillogaritjes dhe mosargumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar, në moszbatim të pikës 3, gërma “d” të VKM nr. 223, datë 23.3.2016.

-Në 1 rast, nga ana e ATP Tiranë, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore të bëra në ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, neni 6 dhe 7, lidhur me vendimin e ATP nr.238, datë 01.12.2016, ku sipas dokumentit të

shpronësimit zëri kadastral i origjinës është “Pemishte” (tokë “Arë”), në një kohë kompensimi është dhënë për tokë “Truall”. Kështu, vlerësimi i pronës për kthim është më i lartë se vlerësimi i pronës së lënë për kompensim, dhe subjekti konsiderohet i kompensuar dhe vlera e lënë për kompensim prej 25,201,890 lekë, në kushtet kur zëri kadastral në kohën e shpronësimit ka qenë tokë “Arë” (Pemishte) dhe është vlerësuar “Truall”, rrjedhimisht *nuk është zbatuar procedura e plotë e rillogaritjes dhe nuk është kryer argumentimi i vlerësimit të kompensimit financiar.*

-Kanë bërë rivlerësim të vendimeve administrative të formës së prerë të cilët kanë vendosur kompensimin financiar, duke rritur vlerën e kompensimit me 7,428,000 lekë për shkak të çmimit më të lartë të truallit për m² në disa Zona Kadastrale. Ky veprim bie në kundërshtim të Vendimit nr.1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese ku citohet “Gjykata Kushtetuese, lidhur me dispozitat që parashikojnë që vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi, vlerëson se ato ngrenë çështjen e “pritshmërisë legjitime”, por sipas ligjit nuk do t’i nënshtrohen rivlerësimit.” dhe qëndrimin të Komisionit të Venecias nr.861/2016, CDL-AD (2016) 023, i cili shprehet “Vendimet gjyqësore ose administrative të formës së prerë, të cilat parashikojnë dhënien e një mase të caktuar kompensimi... nuk do t’i nënshtrohen rivlerësimit sipas ligjit nr.133/2015.”

-Në dosje nuk ndodhen vërtetime për përfitim apo jo nga vlera e aksioneve, obligacioneve, apo çdo lloj kompensimi tjetër, që subjekti i shpronësuar apo trashgimtarit e tij kanë/nuk kanë përfituar më parë.

-Në dosje nuk ndodhet dokumentacion në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, lidhur me bashkërendimin e veprimtarisë dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të ATP Tiranë me Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor (Bashkia, Qarku), sistemin gjyqësor dhe DAMT-në Qark për vërtetimin negativ lidhur me pronësinë mbi tokën bujqësore.

-Në 1 rast, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore të bëra në ligjin nr.133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, neni 6 dhe 7, lidhur me vendimin e ATP nr.238, datë 01.12.2016, ku sipas dokumentit të shpronësimit zëri kadastral i origjinës është “Pemishte” (tokë “Arë”), në një kohë kompensimi është dhënë për tokë “Truall”. Kështu, vlerësimi i pronës për kthim është më i lartë se vlerësimi i pronës së lënë për kompensim, dhe subjekti konsiderohet i kompensuar dhe vlera e lënë për kompensim prej 25,201,890 lekë, në kushtet kur zëri kadastral në kohën e shpronësimit ka qenë tokë “Arë” (Pemishte) dhe është vlerësuar “Truall”, rrjedhimisht *nuk është zbatuar procedura.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Departamenti i Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R